- Blerja, shitja, shkëmbimi, ndërtimi, administrimi vetjak, dhënia me qira palëve të treta dhe organizimi, i stacioneve të shërbimit rrugor, për shpërndarjen e karburantit, lubrifikantëve, produkteve të naftës, si dhe energjisë elektrike, derivateve të hidrogjenit dhe të ngjashme, duke pasur pranë bare, restorante, tavolina të nxehta, qendra tregtare, dyqane tabaccherie, rishitje të tipit monopol, hotele, motele, larje makinash dhe ndihmë e shpejtë në rrugë;
- transport përgjithësisht për vehte dhe për llogari të të tretëve;
- blerja e anijeve për transportin e mallrave dhe të produkteve të sipërpërmendura të naftës;
- shitja dhe dhënia me qira e autovecurave, automjeteve dhe varkave të reja dhe të përdorura;

- tregtia, si vetjake ashtu dhe për llogari të palëve të treta, të gomave, baterive dhe çmimeve të zëvendësimit dhe aksesorëve për automjete në përgjithësi;

- blerja, shitja, shkëmbimi, ndërtimi, rinovimi si vetë dhe për llogari të palëve të treta si publike ashtu edhe private, edhe me tender, e ndërtesave civile, tregtare, industriale, si në Itali dhe jashtë saj dhe në veçanti rafineri, impiante rrugore të depozitimit, edhe pa akcizë për shpërndarjen e karburantit me energji elektrike.

- shoqëria do të mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të pasurive të patundshme që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme nga organi administrativ për të arritur qëllimin e shoqërisë;

-ajo gjithashtu mund të marrë, drejtpërdrejt ose indirekt por jo si një aktivitet mbizotërues dhe jo për qëllime të vendosjes kundrejt publikut, interesat dhe pjesëmarrjet në kompani të tjera ose kompani me objekt të ngjashëm, analog ose të lidhur me të tjin (me përjashtimin e aktiviteteve të përmendura në dekretin legjislativ n.58 të vitit 1998, që kanë bëjnë me shoqëritë e ndërmjetësimit të pasurive) si dhe të kryejë veprime financiare, vetëm për qëllimin e realizimit të objektit të shoqërisë;

-shoqëria do të duhet të veprojë në respekt të legjislacionit lidhur me aktivitetet e rezervuara për të regjistruarit në kolegje, urdhra, regjistra profesionalë, etj., me përjashtim taksativ pra të aktiviteteve të rezervuara sipas ligjit.

-shoqëria synon të përfitojë nga të gjitha lehtësirat e kredive, tatimore dhe fiskale dhe çdo lloj tjetër, parashikuar nga dispozitat e ligjit, të lëshuara dhe të miratuara nga shteti, rajoni dhe Komuniteti Evropian.

4) KOHËZGJATJA: Shoqëria ka kohëzgjatje dei më 31 dhjetor 2068.

5) KAPITALI: Kapitali i shoqërisë është prej 10,000.00 Euro (dhjetë mijë presje zero zero) dhe secilit ortak i jepet një kuotë pjesëmarrjeje unitare por e ndashme.

Vendimet për rritjen e kapitalit mund të parashikojnë kontribute të elementeve të ndjeshëm ndaj vlerësimit ekonomik të ndryshëm nga paratë. Në mungesë të indikacioneve, kontributi duhet të bëhet në të holla.

Në rast të një kontributi që ka si objekt ofrimin e një pune ose shërbimi në favor të shoqërisë, polica ose garancia e përmendur në nenin 2464 të Kodit Civil mund të zëvendësohen nga ortaku me derdhjen e shumës përkatëse si një depozitë në para në Shoqëri.

Kapitali rritet me vendim të Asamblesë me shumicat e parashikuara për ndryshimet në statut.

Ortakët, përveç sa parashikohet në paragrafin vijues - kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen e kapitalit në përpjesëtim me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin preekzistues (neni 2481 - bis i Kodit Civil).

Sidoqoftë, ortakët, me një vendim të marrë me pëlqimin e të gjithëve, që përmban treguesin e pandashmërisë së shprehur të rritjes dhe ndalimin e nënshkrimit nga të tretë, mund të vendosin që kuotat e emetuara si rezultat i rritjes së kapitalit u atribuohen nënshkruesve jo në proporcion me kontributet e tyre.

Ata që ushtrojnë të drejtën për të nënshkruar pjesëmarrjet e emetimit të ri, në rast të një rritje të kapitalit të shoqërisë, me kusht që të bëjnë kërkesë të njëkohshme, kanë të drejtën e parablerjes

HAJILAJ  
Elina Hajilaj  
TR

në nënshkrimin e pjesmarrjeve të pazgjedhura nga ortakët e tjerë, vetëm nëse vendimi për rritjen e kapitalit nuk e përjashton;

nëse rritja e kapitalit nuk nënshkruhet plotësisht nga ortakët, ose për opsion ose për parablerje të pjesmarrjeve të pazgjedhura, Organi administrativ nuk mund të kryejë vendosjen e kuotës së pazgjedhur tek pale të treta që nuk kanë lidhje me strukturën e shoqërisë, përveç nëse vendimi i rritjes e lejon atë.

- E drejta për të nënshkruar pjesmarrjet e emetimit të ri, në rast të një rritje të kapitalit të shoqërisë, nuk zbatohet për ato pjesmarrje të cilat, sipas vendimit të ortakëve duhet të lirohet përmes kontributeve në natyrë ose nëpërmjet ofrimit të punës dhe shërbimeve; në këtë rast i takon ortakëve, që mungojnë ose nuk dëshirojnë, e drejta e tërheqjes referuar nenit 2473 të Kodit Civil.

Në rast të një zvogëlimi të kapitalit të shoqërisë për shkak të humbjeve, mund të hiqet depozitimi pranë selisë së shoqërisë, e dokumentacionit të parashikuar nga neni 2482 bis paragrafi i dytë i Kodit Civil.

6) FINANCIMI I ORTAKËVE-EMETIMI I TITUJVE TË DEBIVE- Ortakët mund të kryejnë financime si me kamatë ashtu dhe pa kamatë, që nuk përbëjnë mbledhje të kursimeve nga publiku në përputhje me dispozitat në fuqi ligjore për çështjet bankare dhe kreditore.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe, derdhjet e kryera nga ortakët duhet të konsiderohen jo me kamatë.

Për rimbursimin e financimeve të ortakëve gjen zbatim dispozita e nenit 2467 të Kodit Civil.

Emetimi i titujve të debisë, referuar nenit 2483 të Kodit Civil, i atribuohet kompetencës së ortakëve.

Vendimi për emetimin e letrave me vlerë duhet të parashikojë kushtet e huasë dhe procedurat e ripagimit.

7) TË DREJTAT E ORTAKËVE: Të drejtat shoqërore u takojnë ortakëve në përpjesëtim me pjesmarrjet në zotërim të secilit.

Në rastin e bashkëpronësisë së një pjesmarrjeje, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët i caktuar në përputhje me modalitetet e parashikuara nga neni 1105 dhe 1106 e Kodit Civil.

Në rastin e pengut, uzufuktit ose sekuestrimit të aksioneve, zbatohen dispozitat e kombinuara të neneve 2352 dhe 2471 bis, të gjitha të Kodit Civil.

Me pëlqimin e të gjithë ortakëve, mund ti jepen ortakëve individual të drejta të veçanta në lidhje me administrimin e shoqërisë ose shpërndarjen e fitimeve, të tilla si përsëmbull: e drejta për të administruar shoqërinë; e drejta për të emëruar një ose më shumë administrator; e drejta për të autorizuar operacione të caktuara paraprakisht; e drejta për të marrë një kuotë fitimesh më shumë në krahasim me pjesmarrjen e tyre në shoqëri. Këto të drejta janë personale, ato nuk mund të transferohen së bashku me pjesëmarrjen as me akt inter vivos as me akt mortis causa; ato mund të modifikohen vetëm me pëlqimin e të gjithë ortakëve.

H. H. HALILAJ  
TRADHTAR I TITULLIT  
E GJATË

Në asnjë rrethanë shoqëria nuk mund të blejë ose pranojë si garanci pjesmarrje të veta, ose të japë hua ose sigurojë garanci për blerjen ose nënshkrimin e tyre (neni 2474 i Kodit Civil).

8) TRANSFERIMI I PJESMARRJEVE ME AKT NDËRMJET TË GJALLËVE: Me pjesmarrje, nënkuptojmë pjesmarrjen në kapital që i takon ortakut ose një pjesë e tij në rast të transferimit të pjesshëm, dhe / ose gjithashtu të drejtat e nënshkrimit përkatës të tij.

Pjesmarrjet mund të transferohen lirshëm me akt ndërmjet të gjallëve, pa pagesë.

Transferimi i pjesmarrjeve me akt ndërmjet të gjallëve, me pagesë, i nënshtrohen disiplinës vijuese.

Në termin "transferim me akt ndërmjet të gjallëve, me pagesë" nënkuptohen të përfshira negociimet e tjetërsimit me pagesë, në kuptimin e gjerë të termit dhe për këtë arsye, përveç shitjes, për shembull shembull, kontrata shkëmbimi, dhënia ose shlyerja e detyrimit në mënyrë tjetër.

Në të gjitha rastet kur natyra e negociimit parashikon një vlerësim tjetër të detyrimit, të ndryshëm nga paraja, ortakut që propozon tjetërsimin, duhet gjithsesi të përcaktojë sasinë e shumës përkatëse në para.

Pjesmarrjet mund të transferohen me pagesë, lirisht, vetëm në favor të bashkëshortit, të të afërmeve që rrjedhin nga njëri tjetri të tjetërsuesit (të çdolloj grade), të kompanive mëmë, filialeve, bashkëpunëtorëve ose që i përkasin të njëjtit grup.

Në hipotezën e transferimit në subjekte të ndryshme nga ato të parashikuara më sipër, të kryera pa vëzhguar atë që përshkruhet më poshtë, ortakëve të tjerë nuk u jepet fuqia për të blerë në mënyrë të njëanshme (shlyerje detyrimi kundrejt pagesës së një çmimi) kuotën përkatëse, por do të ketë joefektivitet, ndaj shoqërisë dhe ndaj ortakëve të tjerë, për transferimin e kryer në mënyrë të parregullt.

Prandaj, blerësi nuk do të ketë të drejtë të ushtrojë votën dhe të drejtat e tjera administrative dhe nuk do të jetë në gjendje të tjetërsojë pjesmarrjet me efekt ndaj shoqërisë.

Prandaj, ortakut i cili synon të transferojë pjesmarrjet e tij, plotësisht ose pjesërisht, me pagesë, duhet të njoftojë të gjithë ortakët me letër rekomande dërguar secilit prej tyre; njoftimi duhet të përmbajë gjeneralitetet e marrësit dhe kushtet e transferimit, duke përfshirë, në veçanti, çmimin dhe mënyrat e pagesës. Ortakët marrës duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes duke i dërguar ortakut ofrues deklaratën e ushtrimit të parablerjes me letër rekomande të dorëzuar në postë jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë (që rezulton nga vula postare) nga data e dërgimit të ofertës së parablerjes.

Në rast të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga më shumë se një ortak, pjesmarrje e ofruar i takon ortakëve të interesuar në proporcion me vlerën nominale të pjesmarrjes në zotërim të secilit prej tyre. Nëse ndonjë nga personat që ka të drejtë për parablerje nuk e ushtron atë, e drejta që i takon atij, rritet automatikisht dhe proporcionalisht në favor të atyre ortakëve që e kanë deklaruar këtë me aktin e ushtrimit të parablerjes që u takon atyre. Njoftimi i qëllimit për transferimin e pjesmarrjeve, i formuluar sipas mënyrave të treguara, është i barabartë me një

ILIRI HALILAJ  
TRADUTTORE GIURISTO

propozim kontraktual në përputhje me nenin 1326 të Kodit Civil. Prandaj, kontrata konsiderohet e mbyllur kur personi që bëri njoftimin, bëhet me dije për pranimin nga ana e palës tjetër.

Nga ky moment, ortakët që ushtron të drejtën e parablerjes është i detyruar të paguajë çmimin sipas modaliteteve të propozimit si dhe të dakordësojë me transferuesin përsëritjen e negociimit në një formë të përshtatshme për regjistrim në regjistrin e biznesit.

E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesmarrjen e ofruar, pasi ky është objekti i propozimit të bërë nga ortakët ofrues; nëse asnjë ortak nuk ka ndërmend të blejë pjesmarrjen e ofruar, ose e drejta ushtrohet vetëm për një pjesë të saj, ortakët ofrues do të jetë i lirë të transferojë të gjithë pjesën e ofruar blerësit të treguar në propozim brenda gjashtëdhjetë ditëve nga dita e marrjes së njoftimit.

E drejta e parablerjes u takon ortakëve edhe kur synohet transferimi i pronësisë së zhveshur ose uzufukti i pjesmarrjes.

E drejta e parablerjes nuk zbatohet në rastin e pengut.

9) VDEKJA E ORTAKUT: Pjesmarrjet janë lehtësisht të transferueshme me suksesion për shkak të vdekjes.

10) TËRHEQJA - E drejta e tërheqjes i takon:

Ortakëve që nuk kanë dhënë pëlqimin për ndryshimin e objektit ose llojit të shoqërisë, bashkimit ose prishjes, transferimin e selisë jashtë vendit, revokimin e gjendjes së likuidimit, eliminimin e një ose më shumë shkaqeve të tërheqjes të parashikuara në këtë Statut, me futjen e kufizimeve në qarkullimin e pjesmarrjeve;

Ortakëve që nuk kanë dhënë pëlqimin për përfundimin e operacioneve që përfshijnë një modifikim thelbësor të objektit të shoqërisë ose një modifikim të rëndësishëm të të drejtave të atribuara ortakëve dhe në marrjen e pjesmarrjeve në ndërmarrjet e tjera tregtare që përfshijnë përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e saj; në të gjitha rastet e tjera të parashikuara sipas ligjit ose nga ky Statut.

Qëllimi i ortakut për të ushtruar të drejtën e tërheqjes, në rastet e parashikuara më sipër, duhet t'i njoftohet Organit Administrativ me letër rekomande, me Njoftim marrje, brenda tridhjetë ditëve nga regjistrimi në Regjistrin e Biznesit të vendimit që legjitimon të drejtën e tërheqjes; nëse fakti që legjitimon tërheqjen është i ndryshëm nga një vendim që do të regjistrohet në Regjistrin e Biznesit, ajo ushtrohet brenda tridhjetë ditësh nga marrja dijeni nga ana e ortakut.

Pjesmarrjet për të cilat ushtrohet e drejta e tërheqjes nuk mund të transferohen.

Tërheqja nuk mund të ushtrohet vetëm për një pjesë të pjesëmarrjes.

Tërheqja konsiderohet e ushtruar në ditën në të cilën njoftimi merret në selinë e shoqërisë.

Tërheqja nuk mund të ushtrohet dhe, nëse është ushtruar tashmë, është joefektive, nëse shoqëria revokon rezolutën dhe / ose vendimin që e legjitimon atë ose nëse është miratuar rezoluta e shpërbërjes së shoqërisë.

Ortakët që tërhiqen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin rimbursimin e pjesmarrjeve të tyre në vlerën që do të përcaktohet në përputhje me sa parashikohet më poshtë.

Gjithsesi pa paragjykuar çdo dipozitë të ndryshme, në përputhje me nenin 2473 të Kodit Civil.

ILIRA HALILAJ  
Ilira Halilaj  
TF

11) PËRJASHTIMI: Ortaku mund të përjashtohet vetëm kur ai është shpallur i falimentuar. Asambleja, me votën e favorshme të së paku gjysmës së kapitalit të shoqërisë dhe pa marrë parasysh, për qëllimet e këtij kuorumi, pjesëmarrjen e ortakut për përjashtimin e së cilit bëhet fjalë, vendos përjashtimin, i cili do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas njoftimit.

Për likuidimin e pjesmarrjeve të ortakut të përjashtuar, zbatohen dispozitat e nenit vijues, me sqarimin se, në rast se është e pamundur të vazhdohet me likuidimin e pjesmarrjeve pa aktivizuar zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë (e ndaluar me ligj), përjashtimi do të humbasë të gjitha efektet.

12) LIKUIDIMI I PJESMARRJEVE: Në hipotezën e shpërbërjes së marrëdhënies shoqërore të ortakut të vetëm, të parashikuar më sipër, pjesmarrjet do të rimbursohen në proporcion me pasurinë e shoqërisë.

Pasuria e shoqërisë përcaktohet nga organi administrativ, pasi ka dëgjuar mendimin e organit të kontrollit, nëse është emëruar, duke marrë parasysh vlerën e tregut të pjesmarrjeve të referuara në momentin efektiv të shkakut të shpërbërjes.

Në rast të mosmarrëveshjes, vlerësimi i pjesmarrjeve, sipas kriterëve të treguara më sipër, kryhet, përmes një raporti me betim, nga një ekspert i caktuar nga Gjykata në rrethin e së cilës ndodhet selia e shoqërisë, i cili parashikon gjithashtu mbi shpenzimet, me kërkesë të palës më të kujdesshme; në këtë rast zbatohet paragrafi i parë i nenit 1349 i Kodit Civil.

Rimbursimi i pjesmarrjeve duhet të bëhet brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve nga njoftimi i ngjarjes nga e cila vijon likuidimi, i bërë shoqërisë.

Rimbursimi mund të bëhet me blerje nga ortakët e tjerë, në proporcion me pjesmarrjet e tyre, ose nga një palë e tretë e identifikuar nga vetë ortakët.

13) ORTAKU I VETËM: Kur nuk ka më një shumicë ortakësh, derdhjet që ende duhet të kryhen, duhet të bëhen brenda nëntëdhjetë ditëve (neni 2464 i Kodit Civil, paragrafi i fundit).

Kur e gjithë pjesmarrja i përket një ortaku të vetëm ose ndryshon personi i ortakut të vetëm, duhet të kryejnë përmbushjet e parashikuara në përputhje me nenin 2470 të Kodit Civil.

Kur krijohet ose rikrijohet shumica e ortakëve, administratorët duhet të depozitojnë deklaratën përkatëse për regjistrim në Regjistrin e Biznesit.

Ortaku i vetëm, ose ai që pushon së qeni i tillë, mund të sigurojë reklamën e parashikuar në paragrafët e mësipërm.

14) ADMINISTRATORËT: Shoqëria mund të administrohet, në mënyrë alternative, me vendim të aksionarëve me rastin e emërimit:

a) nga një administrator i vetëm;

b) nga një këshill administrimi i përbërë nga dy ose më shumë anëtarë, sipas numrit të përcaktuar nga ortakët në kohën e emërimit;

TR  
10

c) nga dy ose më shumë administratorë me kompetenca të përbashkëta ose të ndara, të cilët përbëjnë një këshill administrimi vetëm për aktet e treguara me rastin e emërimit të tyre.

Administratorët mund të jenë edhe jo ortak.

Tek Administratorët zbatohet ndalimi i konkurrencës në përputhje me nenin 2390 të Kodit Civil.

15) KOHËZGJATJA, REVOKIMI, PËRFUNDIMI I DETYRËS-Administratorët qëndrojnë në detyrë deri në revokim ose dorëheqje ose për periudhën e përcaktuar nga ortakët, në momentin e emërimit. Në rast emërimi pa kufizime kohore, por deri në revokim ose dorëheqje, revokimi lejohet në çdo kohë pa pasur nevojë për motivim, me kusht që të jepet njoftimi siç duhet, vetëm nëse ekziston një shkak i drejtë.

Administratorët mund të rizgjidhen.

Përfundimi i detyrës së administratorëve për shkak të skadimit të afatit hyn në fuqi nga momenti në të cilin rindërtohet organi i ri. Në rastin kur është emëruar Këshilli i Administrimit, nëse, për çdolloj arsye, gjysma e këshilltarëve në detyrë mungon, kur janë numër çift, ose shumica kur janë numër tek, bie i gjithë Këshilli i Administrimit.

Nëse, nga ana tjetër, janë emëruar më shumë administratorë, atëher mbarojnë detyrën për çdolloj arsye, një ose më shumë prej tyre:

- \* nëse kanë kompetenca të ndara, të tjerët bien nëse numri është më i ulët se ata që kanë përfunduar detyrën;

- \* nëse me kompetenca të përbashkëta, të tjerët bien në çdo rast.

Ndërkohë, këshilli ose administratorët që kanë rënë nga detyra, me përjashtim të atyre që kanë përfunduar detyrën për shkak të revokimit, mund të kryejnë vetëm veprime të administrimit të zakonshëm.

16) KËSHILLI I ADMINISTRIMIT: Nëse ortakët nuk kanë marrë masa në momentin e emërimit, Këshilli i Administrimit zgjedh një kryetar nga radhët e anëtarëve të tij. Vendimet e Këshillit të Administrimit miratohen nëpërmjet:

A) konsultim me shkrim;

B) shprehje pëlqimi me shkrim;

C) mbledhje kolegjiale.

A \* Konsultimi me shkrim zhvillohet me iniciativë të një ose më shumë administratorëve dhe konsiston në një propozim të një vendimi që duhet të dërgohet (me çdo mjet të përshtatshëm për të siguruar provën e marrjes dhe dërguar në vendbanimin që rezulton nga regjistri i biznesit) të gjithë këshilltarëve, organit të kontrollit nëse është emëruar.

Nga propozimi duhet të rezultojë teksti i saktë i vendimit që do të miratohet. Këshilltarët, kanë pesë ditë kohë për të dërguar me çdo mjet të përshtatshëm për të siguruar proven, pranë selisë së shoqërisë, përgjigjen, e cila duhet të vendoset në fund të dokumentit të marrë. Përgjigja duhet të përmbajë një aprovim ose mohim. Mos përgjigja brenda afatit të lartpërmendur konsiderohet si votë kundër. I takon kryetarit të Këshillit të Administrimit të mbledhë konsultat e marra dhe t'u komunikojë rezultate të gjithë administratorëve, audituesit dhe revizorit, duke treguar:

TR *Ene Fealbe*



këshilltarët pro, kundër ose abstenim, vërejtje të mundshme ose deklarata në lidhje me temën, objekt konsultimi, nëse kërkohet nga vetë këshilltarët dhe datën në të cilën është marrë vendimi nëse shumica e këshilltarëve ka qenë në favor.

B \* Pëlqimi i shprehur me shkrim konsiston në një deklaratë të bërë nga secili administrator, duke iu referuar qartë dhe shprehimisht temës, objekt vendimi, për të cilën, këshilltari që jep pëlqimin, eklaron se është i informuar sa duhet.

Pëlqimet mund të përcillen në selinë e shoqërisë me çdo mjet të përshtatshëm që siguron provën e pëlqimit.

Vendimi merret vetëm nëse ato arrijnë në selinë e shoqërisë, në format e treguara më sipër dhe brenda pesë ditëve nga marrja e komunikimit të parë, pëlqimet e shumicës së administratorëve. I takon kryetarit të Këshillit të Administrimit, që të mbledhë pëlqimet e marra me shkrim dhe t'ua njoftojë rezultatet të gjithë administratorëve, organit të kontrollit, nëse është emëruar, duke treguar këshilltarët pro, kundër dhe abstenim, data në të cilën është marrë vendimi, çdo vërejtje apo deklaratë në lidhje me temën objekt konsultimi, nëse kërkohet nga vetë këshilltarët.

C\* Mbledhja kolegjiale: Në rast të një kërkesë informale nga dy administrator, Këshilli i Administratorëve duhet të vendosë në mbledhje kolegjiale, për të cilin do të përpilohet procesverbali i nënshkruar nga kryetari dhe sekretari. Në këtë rast, kryetari thërret Këshillin e Administrimit, përcakton rendin e ditës, koordinon punën dhe siguron që të gjithë administratorët të jenë të informuar siç duhet për çështjet që do të trajtohen. Thirrja bëhet me anë të një njoftimi dërguar të gjithë administratorëve, organit të kontrollit, nëse është emëruar, me çdo mjet të përshtatshëm për të siguruar provën e marrjes, të paktën tre ditë para takimit dhe, në rast urgjence, të paktën një ditë më parë. Në njoftim përcaktohet data, vendi dhe ora e takimit, si dhe rendi i ditës. Këshilli mbledhet në selinë e shoqërisë ose diku tjetër, mjafton që të jetë në Itali.

Mbledhjet e Këshillit dhe Vendimet e tij janë të vlefshme, edhe pa mbledhje formale, kur marrin pjesë të gjithë administratorët në detyrë dhe në organin e kontrollit, nëse është emëruar. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit mund të kryhen edhe me konferencë audio ose video konferencë, në kushtet e mëposhtme, të cilat do të shënohen në procesverbalin përkatës:

që të jenë të pranishëm në të njëjtin vend kryetari dhe sekretari i mbledhjes, nëse është emëruar, që do të merren me përgatitjen dhe nënshkrimin e procesverbalit, duke qenë se duhet të konsiderohet e kryer mbledhja në vendin e përmendur; që t'i lejohet kryetarit të mbledhjes të konstatojë identitetin e të pranishmëve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit; që t'i lejohet personit që merret me procesverbalin të perceptojë në mënyrë të duhur ngjarjet e takimit objekt të procesverbaleve; që të pranishmit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm për pikat në rendin e ditës, si dhe të shikojë, marrë ose përcjellë dokumenta.

Vendimet e Këshillit të Administrimit janë marrë me votën pro të shumicës së administratorëve në detyrë.

Vendimet ose diskutimet e administratorëve duhet të transkriptohen, pa vonesë, në librin e vendimeve të administratorëve. Dokumentacioni përkatës mbahet nga shoqëria.

  
TRIBUTI DHE REGISTRATO

17) KOMPETENCAT E ORGANIT ADMINISTRATIV- Organi administrativ, cilado qoftë struktura e tij, ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshë dhe të jashtëzakonshëm, asnjë përjashtuar. Në rast të emërimit të Këshillit të Administrimit, ky mund të delegojë të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij në një komitet ekzekutiv të përbërë nga disa prej anëtarëve të tij, ose njërit ose më shumë prej anëtarëve të tij. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e parashikuara në paragrafët e tretë, të pestë dhe të gjashtë të nenit 2381 të Kodit Civil.

Në rastin e emërimit të më shumë administratorëve, kompetencat e administrimit mund t'u atribuohen atyre bashkërisht, veçmas ose me shumicë, ose disa kompetenca të administrimi mund t'i atribuohen veçmas dhe të tjerët sëbashku.

Në mungesë të sqarimeve në kohën e emërimit, kompetencat do të kuptohet se u atribuohen veçmas të gjithë administratorëve.

Në rastin e administrimit të përbashkët, administratorët individualë nuk mund të kryejnë asnjë operacion, përveç në rastet kur është e nevojshme të vepohet urgjentisht për të shmangur shkaktimin e një demi shoqërisë.

Nëse administrimi i besohet veçmas disa administratorëve, në rast kundërshtimi nga një administrator operacionit që një tjetër synon të kryejë, ortakët vendosin për kundërshtimin. Drejtorët, përfaqësuesit ose përfaqësuesit mund të emërohen për të kryer akte të caktuara ose kategori aktevsh, duke përcaktuar kompetencat e tyre.

18) PËRFAQËSIMI: Administratori i vetëm ka përfaqësimin e shoqërisë.

Në rast të emërimit të Këshillit të Administrimit, përfaqësimi i shoqërisë i takon kryetarit të Këshillit të Administrimit dhe këshilltarëve individual të deleguar, nëse janë emëruar, brenda kufijve të delegimit.

Në rast të emërimit të më shumë administratorëve, përfaqësimi i shoqërisë u takon atyre bashkërisht ose veçmas, në të njëjtën mënyrë në të cilën janë dhënë kompetencat e administrimit në kohën emërimit. Përfaqësimi u takon edhe drejtorëve, drejtuesve, punonjësve vartës dhe avokatëve, brenda kufijve të kompetencave të dhëna atyre në aktin e emërimit.

19) KOMPENSIMET E ADMINISTRATORËVE: Administratorët kanë të drejtë për rimbursim të shpenzimeve të bëra për arsye të detyrës së tyre.

Ortakët mund të vendosin një tarifë e cila mund të përbëhet nga një pjesë fikse dhe / ose një pjesëmarrje në fitimet neto që rezultojnë nga bilanci, pas zbritjes së kuotës që do t'i alokohet rezervës ligjore.

Në rast të emërimit të një komiteti ekzekutiv ose këshilltarëve të deleguar, shpërblimi i tyre përcaktohet nga Këshilli i Administrimit në momentin e emërimit.

Asambleja, përveç kësaj, mund t'u njohë administratorëve të drejtën për të marrë, me përfundimin e detyrës, ër shkak të skadimit ose revokimit të mandatit ose për shkak të dorëheqjes, një dëmshpërblim të quajtur "dëmshpërblim për përfundimin e një marrëdhënie të koordinuar dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm". Në këtë rast, Asambleja, do të kryejë, për administratorët në detyrë, një provizion vjetor në ngarkim të shoqërisë, dhe që mund të ndryshojë në përputhje me rezolutat e asamblesë, dhe mund të autorizojë organin administrativ të lidhë me një kompani

TRANSAKALIAJ  
TRADUTTORE  
TRADUTTORE

sigurimesh (me kontraktor shoqërinë dhe të siguruar dhe përfitues administratorët) policat e sigurimit të jetës, të tilla që garantojnë mbulimin e dëmshpërblimit të shkëputjes së bashkëpunimit të koordinuar dhe të vazhdueshëm" që i duhen paguar administratorëve në momentin e përfundimit të marrëdhënies për çdo shkak dhe në çdo kohë që ndodh. Do të jetë përgjegjësia e shoqërisë të kryejë pagesa vjetore të primeve të sigurimit, në favor të kompanisë së zgjedhur, në përpjesëtim me dëmshpërblimin për përfundimin e marrëdhënies së punës që do t'u paguhet administratorëve.

20) AUDITUESI DHE KONTROLLI LIGJOR I LLOGARIVE: Shoqëria mund të emërojë, në përputhje me nenin 2477, paragrafi i parë, të Kodit Civil, një organ kontrolli, i cili, sipas asaj që është vendosur nga ortakët me rastin e emërimit, mund të përbëhet nga një auditues i vetëm ose një kolegji audituesish të përbërë nga tre anëtarë efektivë dhe dy alternues.

Në rastet e parashikuara nga paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 2477 të Kodit Civil, emërimi i organit të kontrollit është i detyrueshëm.

Nëse është emëruar, organi i kontrollit do të ketë kompetencat dhe fuqitë e parashikuara për këtë organ nga disiplina legjislative lidhur me shoqërinë aksionere pasi është në përputhje me parashikimet e nenit 2477 të Kodit Civil.

21) VENDIMI I ORTAKËVE: Ortakët vendosin mbi çështje të rezervuara për kompetencën e tyre sipas ligjit, sipas këtij Statuti, si dhe për temat që një ose më shumë administratorë ose shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë paraqesin për aprovim të tyre.

Gjithsesi, janë rezervuar në competence të ortakëve:

1 \* Miratimi i bilancit (të bëhet brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor të shoqërisë, pa paragjykuar mundësinë e një afati më të gjatë brenda kufijve dhe në kushtet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 2364 të Kodi Civil) dhe shpërndarja e fitimeve;

2\* emërimi dhe struktura e organit administrative;

3\* emërimi i organit të kontrollit;

4\* ndryshimet në statut;

5\* vendimi për të kryer operacione që përfshijnë një ndryshim thelbësor në objekt ose një modifikim të rëndësishëm të të drejtave të ortakëve;

6\* emërimi i likuiduesve dhe kriteret për kryerjen e likuidimit (nenet 2487 dhe 2489 të Kodit Civil);

7\* Propozimi për pranimin në procedurat e falimentimit.

Nuk është i nevojshëm, vendimi i ortakëve që të autorizojë blerjen nga ana e shoqërisë, për një vlerë të barabartë ose më të madhe se një e dhjeta e kapitalit të shoqërisë, të të mirave ose të krediteve të ortakëve themelues, të ortakëve, dhe të administratorëve, gjatë dy viteve nga regjistrimi i shoqërisë në Regjistrin e Biznesit, pa paragjykuar vlerësimin ligjor (neni 2465 paragrafi i dytë i Kodit Civil).

22) VOTA: Vota e ortakut llogaritet në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij. Ortaku që nuk ka pëmbushur detyrimet (ose ortakë, polica e sigurimit të së cilit ose garancia bankare e së cilit kanë

LIP HALILAJ  
TITLLORE HALILAJ  
7

skaduar ose janë bërë joefektive) nuk mund të marrë pjesë në vendimet e ortakëve (neni 2466 paragrafi 4 i Kodit Civil).

23) KONSULTIM ME SHKRIM DHE PËLQIM I SHPREHUR ME SHKRIM: Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në asamble, vendimet e ortakëve mund të miratohen me konsultë me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim.

Konsultimi me shkrim zhvillohet me iniciativën e një ose më shumë administratorëve ose të shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën dhjetë përqind (10%) të kapitalit të shoqërisë dhe konsiston në një propozim vendimi cili duhet t'u dërgohet të gjithë atyre që kanë të drejtë, me çdo mjet të përshtatshëm që siguron provën e marrjes, dërguar në vendbanimin që rezulton nga regjistri i biznesit. Propozimi duhet të tregojë qartë tekstin e saktë të vendimit që do të miratohet. Ortakët kanë tridhjetë ditë për të përcjellë përgjigjen në fund të kërkesës, në selinë e shoqërisë, përveç nëse propozimi tregon një afat tjetër, me kusht që të mos jetë më pak se pesë ditë dhe jo më shumë se tridhjetë ditë. Përgjigja duhet të përmbajë një aprovim ose mohim. Mos përgjigja brenda afatit të lartpërmendur konsiderohet si votë kundër.

I takon Organit Administrativ të mbledhë konsultat e marra dhe të njoftojë rezultatet të gjithë ortakëve, administratorëve dhe organit të kontrollit, nëse është emëruar. duke treguar: ortakët pro, kundër ose abstenim, me kapitalin që përfaqëson secili, datën në të cilën është marrë vendimi, vërejtje të mundshme nëse kërkohet nga vetë ortakët.

Pëlqimi i shprehur me shkrim konsiston në një deklaratë të bërë nga secili ortak, duke iu referuar temës, objekt vendimi, për të cilën, ortaku që jep pëlqimin, deklaron se është i informuar sa duhet.

Pëlqimet mund të përcillen në selinë e shoqërisë me çdo mjet të përshtatshëm që siguron provën e pëlqimit.


Vendimi i ortakëve merret vetëm nëse ato arrijnë në selinë e shoqërisë, në format e treguara më sipër dhe brenda tridhjetë ditëve nga marrja e komunikimit të parë, pëlqimet e shumë ortakëve që arrijnë kuorumin vendimmarrës të përshkruar më poshtë.

I takon Organit Administrativ të mbledhë pëlqimet e marra me shkrim dhe t'ua njoftojë rezultatet ortakëve, administratorëve, organit të kontrollit, nëse është emëruar, duke treguar ortakët pro, kundër dhe abstenim, me kapitalin që përfaqëson secili, data në të cilën është marrë vendimi, vërejtje të mundshme nëse kërkohet nga vetë ortakët.

Të gjitha dokumentet e dërguara në selinë e shoqërisë, në lidhje me formimin e vullnetit të ortakëve, ato duhet të ruhen nga shoqëria, së bashku me librin e vendimeve të ortakëve.

Vendimet e ortakëve, të miratuara në përputhje me këtë nen duhet të transkriptohen, pa vonesë, në librin e vendimeve të ortakëve.

24) ASAMBLEJA: Nëse vendimet kanë të bëjnë me çështjet e përmendura në numrat 4 dhe 5 të nenit 2479, paragrafi i dytë i Kodit Civil, si dhe emërimin e likuiduesve dhe caktimin përkatës të kompetencave dhe gjithashtu propozimin për pranimin në procedurat e falimentimit, si dhe në të gjitha rastet e tjera të parashikuara shprehimisht sipas ligjit, (nenet 2484 nr. 6 dhe 2487 ter të Kodit Civil) ose nga ky statut, ose kur kërkohet nga një ose më shumë administratorë, ose nga

A blue rectangular stamp with a double border. Inside the stamp, the name "Ivana Katic" is written in blue ink. Below the name, there is a handwritten signature in blue ink.

një numër ortakësh që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë, vendimet e ortakëve duhet të miratohen me rezolutë të asamblesë, në përputhje me nenin 2479-bis të Kodit Civil.

Asambleja duhet të thirret nga organi administrativ edhe jashtë selisë së shoqërisë, mjafton të jetë në Itali. Në rast të pamundësisë së të gjithë administratorëve ose të inaktivitetit të tyre, asambleja mund të mbledhet nga organi i kontrollit, nëse është emëruar, apo edhe nga një ortak.

Asambleja mbledhet me njoftim të dërguar tetë ditë para, ose nëse dërgohet më vonë, merret të paktën pesë ditë para datës së caktuar për mbledhjen, me letër rekomande ose me çdo mjet të përshtatshëm që siguron provjen e marrjes, që i është dhënë atyre që kanë të drejtë, në afatet e parashikuara si më sipër.

Në njoftimin e mbledhjes duhet të tregohen dita, vendi, ora e takimit dhe lista e temave që do të diskutohen. Në njoftimin e mbledhjes mund të parashikohet një datë tjetër e thirrjes së dytë, në rast se në mbledhjen e parë. Asambleja nuk rezulton e konstituuar ligjërisht; gjithsesi edhe në mbledhjen e dytë vlejné të njëjtat shumica si tek e para.

Edhe në mungesë të një thirrje zyrtare, mbledhja e aksionerëve konsiderohet e formuar siç duhet kur i gjithë kapitali aksionar merr pjesë në të dhe të gjithë administratorët dhe organi i kontrollit (nëse është emëruar), janë të pranishëm ose të informuar dhe askush nuk kundërshton diskutimin e temës.

25) ZHVILLIMI I ASAMBLESE: Asambleja drejtohet nga administrator i vetëm, nga kryetari i këshillit të administrimit (në rast se është emëruar këshilli i administrimit), ose nga administrator më i vjetër në moshë (në rastin e emërimit të disa administratorëve me kompetenca të ndara ose të përbashkëta). Në rast të mungesës ose pengesës së tyre, asambleja kryesohet nga personi i caktuar nga të pranishmit.

I takon kryetarit të asamblesë të konstatojë krijimin e rregullt të saj, të konstatojë identitetin dhe ligjshmërinë e të pranishmëve - duke bërë shënime në procesverbal, të drejtojë dhe rregullojë zhvillimin e asamblesë dhe të konstatojë dhe shpallë rezultatet e votave.

26) DELEGIMIT: Çdo ortak mund të përfaqësohet, edhe nga një jo ortak, me anë të një delegimi me shkrim, që duhet të ruhet në shoqëri. Delegimi duhet të specifikojë emrin e përfaqësuesit. Nëse delegimi jepet vetëm për asamblenë e vetme, ai gjithashtu ka efekt për thirrjen e dytë dhe në rast të shtyrjes ose vazhdimit.

27) PROCEVERBALI I ASAMBLESE: Vendimet e asamblesë duhet të konsistojnë në procesverbal të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari, nëse është emëruar, ose nga noteri, nëse kërkohet me ligj. Procesverbali duhet të tregojë datën e mbledhjes dhe, gjithashtu edhe bashkëlidhur identitetin e pjesëmarrësve, kapitalin e përfaqësuar nga secili, mënyrat dhe rezultatet e votimit dhe identifikimin e ortakëve në favor, abstenim ose mospajtim.

Procesverbali duhet të përmbledhë, me kërkesë të ortakëve, deklaratat e tyre në lidhje me rendin e ditës. Vendimet merren me ngritje dore, vetëm nëse shumica kërkon apel nominal. Në çdo rast, nuk mund të zbatohet votimi i fshehtë.

ILIRA HALILAJ  
PROUTTORE GIORATO  
Ilira Halilaj

Vendimet, të marra në përputhje me ligjin dhe Statutin e shoqërisë, detyrojnë të gjithë ortakët, edhe nëse mungojnë ose nuk janë në pajtim.

Procesverbali i mbledhjes, edhe nëse hartohet nga noteri, duhet të transkribohet pa vonesë, në librin e vendimeve të ortakëve.

28) KUORUMET KRIJUESE DHE VENDIMARRËSE - Asambleja krijohet rregullisht me praninë e shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë dhe vendos me shumicën absolute të kapitalit të pranishëm.

Në rast të vendimeve të ortakëve që kanë në objekt ndryshimet e statutit ose që sjellin modifikim thelbësor të objektit ose modifikim domethënës të të drejtave të ortakëve ose emërimin e likuiduesve dhe kriteret e likuidimit ose propozimin për pranimin në procedurat e falimentimit, kërkohet vota e favorshme e sa më shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit aksionar.

Në rast të një vendimi të ortakëve të marrë me konsultë me shkrim ose me pëlqimin e shprehur me shkrim, vendimet merren me votën e favorshme të ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit.

Për prezantimin, modifikimin ose fshirjen e të drejtave të dhëna ortakëve individual, në përputhje me paragrafin e tretë të nenit 2468 të Kodit Civil, kërkohet pëlqimi i të gjithë ortakëve.

Gjithsesi, dispozitat e tjera të ligjit ose të këtij statuti të cilat, për vendime të veçanta, kërkojnë shumicë të ndryshme mbeten të paprekura.

29) BILANCI DHE FITIMET: Vitet ushtrimore të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti.

Bilanci duhet të aprovohet brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor të shoqërisë; gjithsesi bilanci mund të miratohet brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor të shoqërisë në rast se nga shoqëria kërkohet të hartojë bilancin e konsoliduar ose kur e kërkojnë nevoja të veçanta në lidhje me strukturën dhe objektin e shoqërisë.

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci, pasi të zbriten të paktën 5% (pesë përqind) për t'u alokuar në rezervën ligjore derisa të ketë arritur një të pestën e kapitalit, do të ndahen midis ortakëve në proporcion me pjesmarrjet në pronësi të secili, përveç nëse vendoset ndryshe nga ortakët.

30) PRISHJA DHE LIKUIDIMI: Shoqëria shpërbëhet për arsyt e parashikuara nga neni 2484 i Kodit Civil.

Asambleja shqyrton shpërbërjen e parakohshme me shumicat e kërkuara për ndryshimin e statutit.

Shkurtimisht, zbatohen për shpërbërjen dhe likuidimin e shoqërisë dispozitat e Kapitullit VIII Libri V të Kodit Civil.

31) KLAUZOLA E ARBITRAZHIT - Çdo mosmarrëveshje, nëse do të lindë ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë, që ka si objekt të saj të drejtat e disponueshme në lidhje me marrëdhëniet sociale, me përjashtim të atyre në të cilët ligji parashikon marrjen pjesë të detyrueshme të prokurorisë, duhet të zgjidhet nga një kolegji arbitral, i përbërë nga tre arbitra, të

gjithë të emëruar nga Kryetari i Gjykatës së vendit ku shoqëria ka selinë. Arbitrat e emëruar në këtë mënyrë do të caktojnë kryetarin e kolegjit arbitral. Selia e kolegjit arbitral do të jetë pranë vendbanimit të kryetarit të kolegjit arbitral. Kolegji arbitral duhet të vendosë brenda nëntëdhjetë ditëve nga emërimi. Kolegji arbitral do të vendosë mbi bazë irracionale sipas kapitalit. Është vendosur tashmë në mënyrë të pakthyeshme që rezolutat dhe vendimet e kolegjit arbitral janë detyruese për palët. Kolegji arbitral do të përcaktojë se si të ndahen kostot e arbitrazhit midis palëve.

Janë subjekt i rregullave të parashikuara sa më sipër, edhe mosmarrëveshjet e ngritura nga administratorët, likuiduesit dhe audituesit ose ato të ngritura kundrejt tyre që kanë si objekt të drejtat e disponueshme në lidhje me marrëdhëniet shoqërore. Për ato që nuk janë parashikuar, zbatohen dispozitat e dekretit legjislativ 17 janar 2003, n. 5.

Fshirja e kësaj klauzole arbitrazhi duhet të miratohet me vendim të ortakëve me shumicën e të paktën dy të tretave të kapitalit të shoqërisë.

Anëtarët që mungojnë ose nuk pajtohen, mund të ushtrojnë të drejtën e tërheqjes brenda nëntëdhjetë ditëve të ardhshme.

32: NJOFTIMET: Njoftimet që duhet të kryhen me letër rekomande ose rekomande a.r. mund të kryhen, me të njëjtin efekt, edhe me rekomande dorëzuar dorazi ortakëve, administratorëve, organit të kontrollit dhe likuiduesve dhe nënshkruhet në fund nga ana e tyre për marrjen.

33) SHTYRJA: Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut, vlejné rregullat ligjore në lidhje me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe dhe, nëse këto të fundit nuk kanë dispozitat përkatëse, vlejné dispozitat e ligjit në lidhje me shoqëritë aksionare.

*Kjo kopje fotostatike, e përbërë prej 18 faqesh  
Është në përputhje me origjinalin dhe lëshohet ditën e sotme.  
8 shkurt 2021*

Firma dhe vula e noterit

*Ronza Giuseppe Fu Luigi*

*Noter në Bellona (S.S)*

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Agjencia tatimore*

*Pullë Poste 16,00 €(gjashtëmbëdhjetë/00)*

*09/02/2021*

*Luigi Ronza*  
TRADUTTORE GIURATO  
*FR*

**PROKURË E REPUBLIKËS**

**PRANË GJYKATËS SË SANTA MARIA CAPUA VETERE**

**Zyra e Çështjeve Civile-Tel:0823.792271 Fax:0823.890068**

**Vulë Apostile**

**(Convention de la Haye du 5 octobre 1961)**

- 1- **Shteti: Itali**  
**Ky akt publik**
- 2- **Është firmosur nga GIUSEPPE RONZA**
- 3- **në cilësinë e NOTERIT**
- 4- **Ëshë I pajisur me vulën e Giuseppe Fu Luigi**  
**NOTER NË BELLONA**

**Dëshmi**

5- **Në S.MARIA C.V 6- më 09/02/2021**  
7-**Nga Prokura e Republikës së S.MARIA C.V -Zyra e Çështjeve Civile**

8- **me numër: 82/2021 i Regjistrit të Vulave Apostile**

**9-Vula**

***Prokurë e Republikës***  
***Pranë Gjykatës së Santa Maria Capua Vetere***

**10-Firma**  
**Zëvendës Prokuror i Republikës**

**Dr. Arianna Zona**

II IDA II II AJ  
Hera...  
7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER REZARTA B. KOÇI

DATE 22/02/2021  
NR REP 1399



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 22/02/2021, para meje Notere REZARTA B. KOÇI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.9, BLV"ZOGU TPARE", NR.97, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES:**

**Ilira Halilaj**, atësia Ahmet, amësia Margarita, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Muhamet Gjollësia; Nd. 54; H. 2; Ap. 24; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 24/08/1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035840109 dhe nr. personal I55824052L,

Përkthyesja është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha Italiane në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

REZARTA B. KOÇI